



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Seanca plenare e Kuvendit

SP-008

Prishtinë, më 23, 24, 29 dhe 30 nëntor 2017

P R O C E S V E R B A L

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 23, 24, 29 DHE 30 NËNTOR 2017

Seancën e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, i ndihmuar nga nënkryetarët e Kuvendit, Aida Dërguti, Xhavit Haliti, Slavko Simiq dhe Kujtim Shala.

Kryetari i hapi punimet e seancës plenare sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 20 nëntor 2017.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Kryetari i GP të PDK-së, Milmi Krasniqi, shprehu indinjatën dhe shqetësimin në lidhje me raportimet e fundit në media ndërkombëtare dhe vendore që flasin për një qasje diskriminuuese dhe paragjyquese në zyrtarët e EULEX-it ndaj ish-ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilët janë gjykuar në procese të ndryshme nga prokurorë dhe gjyqtarë të këtij misioni.

Ai kërkoi nga udhëheqësit e EULEX-it që t'i ofrojnë Kuvendit dhe institucioneve të Kosovës një përgjigje zyrtare dhe të detajuar në lidhje me këto pretendime shumë serioze.

Në shenjë të protestës dhe revoltës në lidhje me këtë, shtoi deputeti Memli Krasniqi, ne sot do ta lëshojmë sallën e Kuvendit dhe kërkojmë që të gjithë deputetët të na bashkëngjiten në këtë veprim.

Pas deklarimit të kryetarit të GP të PDK-së, Memli Krasniqi, deputetët e koalicionit qeveritar të cilët ishin të pranishëm në Seancë (përveç deputetit Milaim Zeka) e lëshuan seancën.

Pastaj, kryesimin e seancës e mori nënkryetarja e Kuvendit, Aida Dërguti.

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën edhe këta deputetë: Glauk Konjufca, Avdullah Hoti, Haxhi Avdyli, Milaim Zeka, Albin Kurti, Naser Rugova dhe Albulena Haxhiu, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesja i ndërpreu punimet e seancës plenare në orën 11:20, ndërsa për vazhdimin e saj do të njoftohen deputetët me kohë.

* * *

E premte, më 24 nëntor 2017

Vazhdimi i seancës plenare

Kryetari i hapi punimet për vazhdimin e seancës plenare të caktuar nga Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 23 nëntor 2017.

Kryetari i GP të LDK-së, Avdullah Hoti, deklaroi se për shkak të mos-konsensusit në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit për caktimin datës për vazhdimin e seance plenare, deputetët e këtij grupi e lëshojnë seancën.

Pastaj, kryetari procedoi me pikën e rendit të ditës, si në vijim:

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti Fadil Beka i parashtroi pyetje ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, në lidhje me formimin dhe fillimin e punës së komisionit mjekësor për invalidët e luftës së UÇK-së.

Ministri Skender Reçica iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputetja Teuta Haxhiu i parashtroi pyetje ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, në lidhje me hartimin dhe procedimin në Kuvend të Projektligjit për statusin e punëtorëve të arsimit shqip në Kosovë të viteve 1990 - 1999.

Ministri Shyqiri Bytyqi iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputeti Andin Hoti i parashtroi pyetje ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, në lidhje me përfshirjen e grup moshave të rinjve në punën vullnetare dhe praktike, sipas Ligjit për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë.

Ministri Kujtim Gashi iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputeti Zafir Berisha i parashtroi pyetje Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, në lidhje me ndërmarrjen e masave nga ana e Qeverisë për bordet e ndërmarrjeve publike, pasi në Raportin Vjetor të Zyrës Kombëtare të Auditorit për vitin 2016, janë gjetur se disa ndërmarrje publike në Kosovë janë duke operuar me humbje. Kryeministri Ramush Haradinaj iu përgjigj deputetit lidhur me pyetjen e parashtruar.

* * *

Deputeti Korab Sejdiu i kishte parashtruar pyetje për përgjigje me shkrim ministrit të Drejtësisë, Abelard Tahiri, në lidhje me mbikëqyrjen e përfaqësuesve juridikë për mbrojtjen e interesave të Kosovës në rastin e padisë së ngritur të ACP Axos Capital kundër Republikës së Kosovës në Gjykatën e Arbitrazhit.

Ministri Abelard Tahiri nuk i është përgjigjur pyetjes së parashtruar nga deputeti në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit.

Deputeti Korab Sejdiu i kishte parashtruar pyetje për përgjigje me shkrim ministrit të Financave, Bedri Hamza në lidhje me bazën ligjore për emetimin e letrave me vlerë, si dhe përgatitjen e ndonjë nisme ligjore për rregullimin sa më efikas të fushës për emetimin e letrave me vlerë në Republikën e Kosovës.

Ministri Bedri Hamza nuk i është përgjigjur pyetjes së parashtruar nga deputeti në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit.

Deputeti Korab Sejdiu i kishte parashtruar pyetje për përgjigje me shkrim ministrit të Punëve të Brendshme, Flamur Sefaj në lidhje me raportimet në media se Mali i Zi ka filluar të ushtrojë pushtet mbi një pjesë të territorit të Republikës së Kosovës ende pa u ratifikuar Marrëveshja për kufirin shtetëror në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Ministri Flamur Sefaj nuk i është përgjigjur pyetjes së parashtruar nga deputeti në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit.

Pastaj, kryetari, në mungesë të kuoromit, e ndërpreu seancën në orën 10:35, për të vazhduar më 29 nëntor 2017, në orën 10:00.

* * *

E mërkurë, më 29 nëntor 2017

Vazhdimi i seancës plenare

Kryesuesi i hapi punimet e seancës plenare, e filluar më 23 nëntor 2017.

Në fillim të seancës, deputetja Blerta Deliu-Kodra, në emër të Grupit joformal të grave deputete, diskutoi në lidhje me Ditën ndërkombëtare për eliminimin e dhunës ndaj grave, diskutimi i të cilës është dhënë i plotë në transkript.

Më pas, kryesuesi procedoi me pikat e rendit të ditës, si në vijim:

3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme

Kuvendi i miratoi pa vërejtje procesverbalet e seancave plenare të mbajtura më 25, 26 dhe më 31 tetor 2017.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit, si dhe i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-31 për Lirinë Fetare në Kosovë, diskutuan deputetët: Duda Balje, në emër të Komisionit Funkcional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione; Glauk Konjufca, në emër të GP të LVV-së; Lirije Kajtazi, në emër të GP të LDK-së; Luljeta Veselaj - Gutaj, në emër të GP të PDK-së; Sasha Milosavljeviq, në emër të GP të Listës serbe; Teuta Haxhiu, në emër të GP të AAK-së; Bilall Sherifi, në emër të GP të “Nismës për Kosovën”; Albert Kinolli, në emër të GP “6+”; Sami Kurteshi, Mirjeta Kalludra, Fatmir Xhelili, Fikrim Damka, Arbër Rexhaj, Vjosa Osmani-Sadriu, Milaim Zeka, Hajdar Beqa, Ismajl Kurteshi, Haxhi Avdyli, Ali Lajçi, Kujtim Shala, Emilija Rexhepi, Valon Ramadani, Lumir Abdixhiku, Nait Hasani, Dardan Molliqaj dhe Memli Krasniqi, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Në vazhdim, kryesuesi sqaroi procedurat e veçanta, sipas nenit 81 dhe amendamentin 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, për miratimin e këtij projektligji.

Më pas, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 61,
Kundër ----- 4,
Abstenime ----- 13.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-001 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë.
2. Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kryeqytetin e Republikës së Kosovës/Prishtinën

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

Në emër të Qeverisë, ministri Kujtim Gashi, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit, si dhe i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për kryeqytetin e Republikës së Kosovës/Prishtinën, diskutuan deputetët: Nait Hasani, në emër të Komisionit Funkcional për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media; Shqipe Pantina, në emër të GP të LVV-së; Imet Rrahmani, në emër të GP të LDK-së; Xhevahire Izmaqi, në emër të GP të PDK-së; Rasim Selmanaj, në emër të GP të AAK-së; Milaim Zeka, në emër të GP të "Nismës për Kosovën"; Albert Kinolli, në emër të GP "6+"; Faton Topalli, Lumir Abdixhiku, Daut Haradinaj, Xhelal Sveçla, Lutfi Zharku, Dardan Sejdiu, Naser Rugova, Sami Kurteshi dhe Besa Baftiu, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për kryeqytetin e Republikës së Kosovës/Prishtinën.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 67,
Kundër ----- 1,
Abstenime ----- 8.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-012 për kryeqytetin e Republikës së Kosovës/Prishtinën.

2. Ngarkohet Komisioni FunkSIONal dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tatimin në pronën e paluajtshme

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONal për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

Ministri i Financa, Bedri Hamza, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit, si dhe i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për tatimin në pronën e paluajtshme diskutuan deputetët: Lumir Abdixhiku, në emër të Komisionit FunkSIONal për Buxhet dhe Financa dhe në emër të GP të LDK-së; Dardan Molliqaj, në emër të GP të LVV-së; Safete Hadërgjonaj, në emër të GP të PDK-së; Blerim Kuçi, në emër të GP të AAK-së; Enver Hoti, në emër të GP të “Nismës për Kosovën”; Fikrim Damka, në emër të GP “6+”, Qëndron Kastrati, Lutfi Zharku dhe Evgjeni Thaçi-Dragusha, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për Tatimin në Pronën e Paluajtshme.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 48,
Kundër ----- 1,
Abstenime ----- 11.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme.

2. Ngarkohet Komisioni FunkSIONal dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/26 për trashëgiminë në Kosovë

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia rekomandon miratimin e tij.

Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit. Në fund, ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/26 për Trashëgiminë në Kosovë, diskutuan deputetët: Albulena Haxhiu, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe në emër të GP të LVV-së; Korab Sejdiu, në emër të GP të LDK-së; Hajdar Beqa, në emër të GP të PDK-së; Igor Simiq, në emër të GP të Listës serbe; Shkumbin Demaliaj, në emër të GP të AAK-së; Zafir Berisha, në emër të GP të “Nismës për Kosovën”; Bahrim Shabani, në emër të GP “6+”; Drita Millaku, Valentina Bunjaku-Rexhepi, Emilija Rexhepi, Mirjeta Kalludra, Memli Krasniqi, Time Kadrijaj, Arbër Rexhaj, Mimoza Kusari-Lila dhe Lirije Kajtazi, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/26 për trashëgiminë në Kosovë.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 53,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 16.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-008 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/26 për trashëgiminë në Kosovë.
2. Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

Në emër të Qeverisë së Kosovës, Ministri Kujtim Gashi, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit. Ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës, diskutuan deputetët: Hajdar Beqa, në emër të Komisionit Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe në emër të GP të PDK-së; Sami Kurteshi, në emër të GP të LVV-së; Imet Rrahmani, në emër të GP të LDK-së; Shkumbin Demaliaj, në emër të GP të AAK-së; Milaim Zeka, në emër të GP të “Nismës për Kosovën”; Bahrim Shabani, në emër të GP “6+” dhe nënkryetari i Kuvendit, Xhavit Haliti, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 39,
Kundër ----- 13,
Abstenime ----- 15.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-008 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës.

2. Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-007 për procedurën jokontestimore

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit. Ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-007 për procedurën jokontestimore, diskutuan deputetët: Hajdar Beqa, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe në emër të GP të PDK-së; Sami Kurteshi, në emër të GP të LVV-së; Mirjeta Kalludra, në emër të GP të LDK-së; Bekë Berisha, në emër të GP të AAK-së; Milaim Zeka, në emër të GP të “Nismës për Kosovën” dhe deputeti Islam Pacolli, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-007 për procedurën jokontestimore.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 53,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 15.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-007 për procedurën jokontestimore.
2. Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndërmjetësim

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit. Ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për Ndërmjetësim, diskutuan deputetët: Hajdar Beqa, në emër të Komisionit Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe në emër të GP të PDK-së; Sami Kurteshi, në emër të GP të LVV-së; Avdullah Hoti, në emër të GP të LDK-së; Shkumbin Demaliaj, në emër të GP të AAK-së; Albulena Balaj-Halimaj, në emër të GP të “Nismës për Kosovën”, si dhe deputetët Glauk Konjufca dhe Mirjeta Kalludra, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për ndërmjetësim.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 48,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 13.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-009 për ndërmjetësim.
2. Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shoqëritë tregtare

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Bajram Hasani, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit. Ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për shoqëritë tregtare, diskutuan deputetët: Sala Berisha-Shala, në emër të Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe

Zhvillim Rajonal; Dardan Molliqaj, në emër të GP të LVV-së; Hykmete Bajrami, në emër të GP të LDK-së; Memli Krasniqi, në emër të GP të PDK-së; Teuta Haxhiu, në emër të GP të AAK-së; Bilall Sherifi, në emër të GP të “Nismës për Kosovën”, si dhe deputetët Korab Sejdiu, Islam Pacolli, Mimoza Kusari-Lila, Blerta Deliu-Kodra dhe Milaim Zeka, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesuesi, pas diskutimeve për këtë projektligj, konstatoi se nuk ka kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

Votimi i këtij projektligji është proceduar më 30 nëntor 2017.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 89,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-016 për shoqëritë tregtare.
2. Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për standardizim

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

Kryesuesi e ftoi Ministrin e Tregtisë dhe Industrisë, që para deputetëve ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Bajram Hasani, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit. Ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për Standardizim, diskutuan deputetët: Sala Berisha-Shala, në emër të Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, si dhe në emër të GP të PDK-së; Dardan Molliqaj, në emër të GP të LVV-

së; Hykmete Bajrami, në emër të GP të LDK-së; Ahmet Isufi, në emër të GP të AAK-së dhe Bilall Sherifi, në emër të GP të “Nismës për Kosovën”, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesuesi, pas diskutimeve për këtë projektligj, konstatoi se nuk ka kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

Votimi i këtij projektligji është proceduar më 30 nëntor 2017.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 91,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-019 për standardizim.
2. Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-214

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Në emër të Qeverisë, Ministrja Albena Reshitaj, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit. Ajo i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-214,

diskutuan deputetët: Xhelal Sveçla, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës; Rexhep Selimi, në emër të GP të LVV-së; Avdullah Hoti, në emër të GP të LDK-së; Fatmir Xhelili, në emër të GP të PDK-së; Blerim Kuçi, në emër të GP të AAK-së; Zafir Berisha, në emër të GP të “Nismës për Kosovën”; Glauk Konjufca dhe Armend Zemaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesuesi pas diskutimeve për këtë projektligj, konstatoi se nuk ka kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

Votimi i këtij projektligji është proceduar më 30 nëntor 2017.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 80,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 13.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-013 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-214.

2. Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

14. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për infrastrukturën kritike

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Në emër të Qeverisë, Ministria Albena Reshitaj, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit. Ajo i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për infrastrukturën kritike, diskutuan deputetët: Xhelal Sveçla, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës; Drita Millaku, në emër të GP të LVV-së; Avdullah Hoti, në emër të GP të LDK-së; Fadil Beka, në emër të GP të PDK-së; Blerim Kuçi, në emër të GP të AAK-së; Bilall Sherifi, në emër të GP të “Nismës për Kosovën”; Rexhep Selimi dhe Armend Zemaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesuesi, pas diskutimeve për këtë projektligj, konstatoi se nuk ka kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

Votimi i këtij projektligji është proceduar më 30 nëntor 2017.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 93,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-014 për infrastrukturën kritike.
2. Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Noterinë

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

Kryesuesi e ftoi Ministrin e Drejtësisë, që para deputetëve ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit. Ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për Noterinë, diskutuan deputetët: Hajdar Beqa, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe në emër të GP të PDK-së; Sami

Kurteshi, në emër të GP të LVV-së; Korab Sejdiu, në emër të GP të LDK-së; Jasmina Zhivković, në emër të GP të Listës serbe; Shkumbin Demaliaj, në emër të GP të AAK-së; Bilall Sherifi, në emër të GP të “Nismës për Kosovën”; Drita Millaku, Islam Pacolli dhe ministri Abelard Tahiri, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesuesi, pas diskutimeve për këtë projektligj, konstatoi se nuk ka kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

Votimi i këtij projektligji është proceduar më 30 nëntor 2017.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 72,

Kundër-----0,

Abstenime-----21.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-010 për Noterinë.

2. Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

* * *

E enjte, më 30 nëntor 2017

Vazhdimi i seancës plenare

Kryesuesi procedoi me pikat e papërfunduara, si në vijim:

16. Rekomandimi i Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media për shkarkimin e një anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët e Kuvendit se Komisioni FunkSIONAL për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media i ka rekomanduar Kuvendit shkarkimin e anëtares së Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, znj. Mimoza Hasani-Pllana.

Kryesuesi e ftoi zëvendëskryetaren e Komisionit funksional që para deputetëve të Kuvendit ta paraqes dhe arsyetojë rekomandimin e Komisionit.

Znj. Shqipe Pantina zëvendëskryetare e Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media e paraqiti dhe arsyetoi rekomandimin e Komisionit funksional.

Lidhur me rekomandimin e Komisionit funksional për shkarkimin anëtares së Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës diskutuan: Milaim Zeka, Nait Hasani, Teuta Haxhiu, Valentina Bunjaku-Rexhepi dhe Xhevahire Izmaqi, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim rekomandimin e komisionit funksional për shkarkimin e anëtares së Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 56,
Kundër -----2,
Abstenime ----- 16.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Znj. Mimoza Hasani-Pllana shkarkohet nga pozita e anëtares së Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

17. Shqyrtimi i raportit vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2016

Kryesuesi i njoftoi deputetët e Kuvendit se Komisioni Funksional për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2016 dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime.

Kryesuesi e ftoi kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë rekomandimin e komisionit funksional.

Kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, Lumir Abdixhiku, e paraqiti dhe e arsyetoi rekomandimin e komisionit funksional lidhur me Raportin vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2016. Diskutimi i tij është dhënë në transkript.

Në vazhdim, kryesuesi e hapi debatin për raportin vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2016.

Lidhur me raportin vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2016 diskutuan: Dardan Sejdiu, në emër të GP të LVV; Lumir Abdixhiku, në emër të GP të LDK-së; Safete Hadërgjonaj, në emër të GP të PDK-së; Blerim Kuçi, në emër të GP të AAK-së; Enver Hoti në emër të GP të “Nismës për Kosovën”; Allbert Kinolli, në emër të GP “6+”, si dhe deputetët: Faton Topalli, Milaim Zeka, Shqipe Pantina, Avdullah Hoti, Islam Pacolli,

Bilall Sherifi, Naser Rugova, Sami Kurteshi, Gani Dreshaj, Hajdar Beqa dhe ministri Bedri Hamza, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim raportin vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2016.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----	67,
Kundër -----	10,
Abstenime -----	12.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet raporti vjetor i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2016.

18. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016

Kryesuesi i njoftoi deputetët e Kuvendit se Komisioni FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor Financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016 dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime.

Ministri i Financave, Bedri Hamza, e paraqit dhe e arsyetoi raportin vjetor financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2016. Diskutimi i tij është dhënë në transkript.

Kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, Lumir Abdixhiku, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit funksional lidhur me Raportin Financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016. Diskutimi i tij është dhënë në transkript.

Në vazhdim, kryesuesi e hapi debatin për raportin vjetor Financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016.

Lidhur me raportin vjetor Financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016 diskutuan: Naser Osmani, në emër të GP të LDK-së; Safete Hadërgjonaj, në emër të GP të PDK-së; Blerim Kuçi, në emër të GP të AAK-së dhe Enver Hoti në emër të GP të “Nismës për Kosovën”, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim raportin vjetor financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 47,
Kundër -----17,
Abstenime ----- 0.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet raporti vjetor financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016.

19. Shqyrtimi i raportit vjetor për funksionimin e Sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike në Sektorin Publik të Kosovës për vitin 2016

Kryetari i njoftoi deputetët e Kuvendit se Komisioni Funkcional për Mbikëqyrjen e Financave Publike e ka shqyrtuar raportin vjetor për funksionimin e Sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike në Sektorin Publik të Kosovës për vitin 2016 dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime.

Zëvendëskryetari i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, Mërgim Lushtaku, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit funksional lidhur me Raportin vjetor për funksionimin e Sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike në Sektorin Publik të Kosovës për vitin 2016.

Në vazhdim, kryetari e hapi debatin për raportin vjetor për funksionimin e Sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike në Sektorin Publik të Kosovës për vitin 2016.

Lidhur me raportin vjetor për funksionimin e Sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike në Sektorin Publik të Kosovës për vitin 2016 diskutuan: Faton Topalli, në emër të GP të LVV, Avdullah Hoti, në emër të GP të LDK-së; Andin Hoti, në emër të GP të PDK-së; Verica Čeranić, në emër të GP të Listës serbe, Milaim Zeka, në emër të GP të Nismës për Kosovën dhe Allbert Kinolli, në emër të GP “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim raportin vjetor për funksionimin e Sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike në Sektorin Publik të Kosovës për vitin 2016.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 65,
Kundër ----- 1,
Abstenime ----- 2.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet raporti vjetor për funksionimin e Sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike në Sektorin Publik të Kosovës për vitin 2016.

20. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga komuniteti serb

Meqë nuk kishte konsensus ndërmjet grupeve parlamentare për kryesimin e komisioneve ad hoc me rotacion, kryetari i Kuvendit propozoi që formimi i Komisionit për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga komuniteti serb, si dhe formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarit të Bordit për Ankesa të shtyhen për seancën tjetër të radhës.

22. Zgjedhja e një (1) anëtari të Komisionit të Pavarur të Medieve

Kryetari propozoi që të procedohet përnjëherë me votimin e fshehtë për pikat e rendit të ditës: Zgjedhja e një (1) anëtari të Komisionit të Pavarur të Medieve dhe Zgjedhja e dy (2) anëtarëve të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës.

Kuvendi e miratoi propozimin e kryetarit.

Pastaj, Kryetari e ftoi kryetaren e Komisionit ad hoc që para deputetëve të Kuvendit ta paraqes dhe arsyetojë raportin e Komisionit.

Znj. Shqipe Pantina, kryetare e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Komisionit të Pavarur të Medieve, e paraqiti dhe arsyetoi raportin dhe rekomandimin e Komisionit.

Në vazhdim, kryetari e ftoi kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa ta paraqesë dhe arsyetojë propozimin e Komisionit funksional.

Z. Lumir Abdixhiku para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi propozimin e Komisionit për zgjedhjen e dy (2) anëtarëve të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës.

Pastaj, kryetari kërkoi nga grupet parlamentare që ta propozojnë nga një anëtar në Komisionin votues, për të zhvilluar procedurat e votimit të fshehtë.

Me propozimin e grupeve parlamentare, Kuvendi e zgjodhi Komisionin votues në këtë përbërje:

Saranda Bogujevci, GP, LV,
Fidan Rekaliu, GP, LDK,
Hajdar Beqaj, GP, PDK,
Srdjan Mitrović, GP, LS,

Rasim Selmanaj, GP, AAK,
Enver Hoti, GP “Nisma” dhe
Bahrim Shabani, GP “6+”.

Kryetari i ftoi anëtarët e Komisionit votues që të fillojnë me procedurat e votimit të fshehtë për pikat e rendit të ditës: 22. *Zgjedhja e një (1) anëtari të Komisionit të Pavarur të Mediave*; 23. *Zgjedhja e dy (2) anëtarëve të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës*.

Pastaj, Kryetari i ftoi sipas listës deputetët e Kuvendit për të votuar.

Pas zhvillimit të procedurës së votimit të fshehtë, në emër të Komisionit votues rezultatin e votimit për zgjedhjen e një anëtari të Komisionit të Pavarur të Medieve e paraqiti deputetja Saranda Bogujevci.

Rezultati i votimit ishte:

- Në votim kishin marrë pjesë 91 deputetë.
- Të pavlefshme ishin 2 vota.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar ishin, si në vijim:

Driton Qeriqi - 10 vota,
Vlorë Berisha - 79 vota.

Kryesuesi konstatoi se në bazë të rezultateve të votimit, në pajtim me nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të neneve 10.1, 10.5, 11 dhe 13 të Ligjit nr.04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Znj. Vlorë Berisha zgjidhet anëtare e Komisionit të Pavarur të Medieve, me mandat tre (3) vjeçar.

Ndërsa, rezultatin për emërimin e dy anëtarëve të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës e paraqiti deputeti Hajdar Beqa.

Rezultati i votimit ishte:

- Në votim kishin marrë pjesë 91 deputetë.
- Të pavlefshme ishin 3 vota.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar për një (1) anëtar të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës ishin, si në vijim:

Hajdar Korbi - 70 vota,
Mark Crawford - 4 vota.

Ndërsa për anëtarin tjetër të Bordit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për këshillimin dhe përfaqësimin e punëdhënësve në Kosovë rezultati i votimit ishte

Valdrin Kasumaj - 39 vota,
Flamur Keqa, - 09 vota,
Ejup Qerimi, - 37 vota.

Kryesuesi konstatoi se në bazë të rezultateve të votimit, në pajtim me nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4.6 të Ligjit nr.04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115, Ligjin nr. 04/L-168 dhe me Ligjin nr. 05/L-116 si dhe të nenit 51 të Rregullores së Kuvendit, Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Z. Hajdar Korbi zgjidhet anëtar i Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës me mandat katër (4) vjeçar.

Ndërsa për anëtarin e Bordit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për këshillimin dhe përfaqësimin e punëdhënësve në Kosovë, asnjëri nga kandidatët e propozuar nuk i fitoi votat e nevojshme.

Raundi i dytë i votimit u përsërit me dy kandidatët që kishin fituar më shumë vota:

Valdrin Kasumaj dhe
Ejup Qerimi.

Kryesuesi i ftoi deputetët një nga një të votonin për zgjedhjen e 1 (një) anëtarit të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për këshillimin dhe përfaqësimin e punëdhënësve në Kosovë.

Pas zhvillimit të procedurës së votimit, në emër të Komisionit votues rezultatin e votimit e paraqiti deputeti Hajdar Beqa.

Rezultati i votimit ishte:

- Në votim kishin marrë pjesë 74 deputetë.
- Të pavlefshme ishin 7 vota.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar ishin si në vijim:

Valdrin Kasumaj, - 41 vota,
Ejup Qerimi, - 26 vota.

Kryesuesi konstatoi se në bazë të rezultateve të votimit, Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Z. Valdrin Kasumaj zgjidhet anëtar i Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për këshillimin dhe përfaqësimin e punëdhënësve në Kosovë, me mandat katër (4) vjeçar.

Kryesuesi i mbylli punimet e seancës më 30 nëntor 2017, në orën 17:35.

Kryetari i Kuvendit:

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale